



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	08-06-2022	2	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Hr Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/S/H/C/C	3338/2022		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.419/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.419/2022 të datës 26.04.2022, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokati me adresë kundër Vendimit me Nr.57/2022, ref.1245/2022 të datës 25.03.2022, i nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “transfer”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1. neni 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datën 08.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.419/2022 e datës 26.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

II.Shfuqizohet Vendimi me Nr.57/2022 me nr.ref.1245 /2022 i datës 25.03.2022, i nxjerr nga zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

III.Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës Drejtor i Departamentit të Sportit sipas Akt Emërimit të datës 29.01.2014, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës që rrjedhin sipas akt emërimit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (në tekstin në vazhdim MKRS-së), më datë 25.03.2022 ka nxjerr Vendim me Nr.57/2022 me të cilin ka bërë caktimin e ankuesit përkohësisht nga pozita Drejtor i Departamentit të Sportit në MKRS-së në pozitën Udhëheqës i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim avokati me datë 26.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2372/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.57/2022, ref.1245/2022 të datës 25.03.2022, i nxjerrë nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së, me pretendimet ankimore se vendimi është nxjerr me shkelje procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek MKRS-së, ndërsa ky i fundit më datë 13.05.2022 ka dërguar provat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës dhe me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2372/2022 të datës 26.04.2022 e parashtruar nga ankuesi përmes avokatit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 05.04.2022; Akt emërimi i datës 29.04.2014 me nr.228/2014; Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 06.12.2021 me nr.KD.nr.07/2021 i Ministrisë së Kulturës , Rinisë dhe Sportit; Vendimi i datës 21.02.2022 me numër protokollit 912/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 13.05.2022 me numër protokollit 2778/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Vendimi i datës 25.03.2022 me nr.57/2022 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, **SEPSE:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe pretendimet e ankuesit lidhur me kundërshtimin e Vendimit me Nr.57/2022 me nr.ref.1245 /2022 i datës 25.03.2022, i nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i MKRS-ja me të cilin vendim transferohet përkohësisht nga pozita Drejtor i Departamentit të Sportit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në pozitën Udhëheqës i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Ankuesi i punësuar sipas Akt emërimit të datës 29.01.2014 në pozitën Drejtor i Departamentit të Sportit në MKRS-së, Komisioni Disiplinor me Vendimin me nr. KD Nr.17/2021 të datës 06.12.2021 i shqiptohet masa disiplinore " Largim nga Shërbimi Civil " në MKRS-së. I pakënaqur me Vendimin me nr. KD Nr.17/2021 i datës 06.12.2021 të Komisionit Disiplinor në MKRS-së, ankuesi me datën 24.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli me vendimin e datës 21.02.2022 me numër protokollit 912/2022 ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit duke zëvendësuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" në MKRS-së, në masën disiplinore "Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen e pagës për tre(3) vjet".

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i MKRS-së me datën 21.03.2022 ka nxjerr vendimin me nr.1/21/2022 me të cilin ka zbatuar vendimin e Këshillit A.nr.1217/2021, ndërsa me vendimin e datës 25.03.2022 Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i MKRS-së e transferon në pozitën Udhëheqës i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Vendimi Nr.57/2022 me nr.ref.1245 /2022 i datës 25.03.2022, i nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i MKRS-së për transferim të përkohshëm nuk është bërë konform dispozitave ligjor të nenit 52 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, si dhe Rregullores (QRK) NR.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve të Punës në Shërbimin Civil, si rrjedhojë Kolegji e konsideron që vendimi i Këshillit nuk është zbatuar ashtu siç parashihet me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, i cili përcakton se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar ligjshmërinë e Vendimit me Nr.57/2022 me nr.ref.1245 /2022 i datës 25.03.2022, i nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së, i cili është bazuar në dispozitat ligjore të nenit 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, që përcaktohet se: *“1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve”*, si dhe nenin 4 paragrafi 1,2,3 dhe 4 dhe nenin 5 paragrafi 1,2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ka konstatuar se ky vendim është nxjerr në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, sepse ankuesi nuk është transferuar në pozitën e njëjtë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në pretendimin e ankuesit ka konstatuar se vendimi me Nr.57/2022 i datës 25.03.2022, i nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i MKRS-së, është nxjerrë në kundërshtim me nenin 47 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse nuk përmban elementet e aktit administrativ ashtu siç përcaktohet në nenin 47, vendimi ka vetëm hyrjen dhe dispozitivin ndërsa nuk ka arsyetimin dhe as pjesën përmblyëse duke përfshi këshillën juridike si elemente të detyrueshme që duhet të ketë një akt administrativ, Kolegji ka konstatuar se ky vendim përkundër që është referencë ligjore me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi i njëjti është në kundërshtim pikërisht me nenin 4 paragrafin 1,4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil ku përcaktohet se *“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit dhe Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit. 5. Pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme”*. Kolegji po ashtu ka konstatuar se ky vendim përkundër që me rastin e nxjerrjes së vendimit i referohet nenit 5 i njëjti sipas konstatimit të kolegjit është në kundërshtim po ashtu me nenin 5 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se me rastin e transferimit të përkohshëm duhet të ketë kërkesë nga institucioni përkatës ku transferohet që në këtë rast nuk na është ofruar asnjë provë nga institucioni në këtë rast MKRS-së si organ i punësimit ndërsa sipas paragrafit 2 të nenit 5 transferimi i përkohshëm miratohet nga njësia përgjegjëse në këtë rast nga udhëheqësi i burimeve

njerëzore në kuadër të MKRS-së e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që transferohet, dhe me rastin e marrjes së vendimit për transferim të përkohshëm duhet të ketë një analizë përmbajtësore rreth kritereve që kërkohen për pozitën që kërkohet të transferohet, dhe ndërlidhur me këto kushte që kërkohen me rastin e transferimit kolegji me rastin e vendosjes në lidhje me këtë ankesë sa i përket transferimit ka konstatuar se organi i punësimit-MKRS-ja, siq potencuam më lartë përkundër që i është dërguar kërkesa për përgjigje në ankesë, në përgjigjen e datës 13.05.2022 të pranuar nga Menaxheri i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore nuk na ka ofruar asnjë dokument/provë relevante që argumenton bazën ligjore të transferimit, në këtë rast mungon kërkesa nga institucioni ku transferohet ,aprovimet nga mbikëqyrësit e drejtpërdrejt për transferim të përkohshëm të nëpunësit civil, vendimi/njoftimi i njesisë së burimeve njerëzore për transferim të përkohshëm, dhe argumentimi i plotësisht të kritereve të pozitës ku transferohet nëpunësi civil, dhe mbi këtë bazë të specifikuar më lartë kolegji konstaton se pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u ndërlidhur me pretendimin ankimor konstaton se vendimi për transferim të përkohshëm është në kundërshtim me Rregulloren nr.26/2020 për klasifikim të vendeve të punës në shërbimin civil, nga se pozita drejtor departamenti është pozitë e nivelit të mesëm drejtues ndërsa udhëheqës i personelit është pozitë e nivelit të ulët drejtues dhe rrjedhimisht nuk janë pozita të kategorisë së njëjtë dhe mbi këto arsye transferimi është në kundërshtim edhe me nenin 4 paragrafi 1 i Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil dhe mbi këto arsye pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit me Nr.57/2022 i datës 25.03.2022 për transferim, i nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i MKRS-së, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në pretendimin e ankuesit, konstaton se Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë konkretisht neni 52, ka paraparë transferimin e përkohshëm të nëpunësve civil në disa raste, si rrjedhojë transferimi i ankuesit ka ndodhur si Zëvendësues i Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, kështu që fakti që ankuesi pozitën e Drejtorit të Departamentit të Sportit në MKRS-së e ushtron që nga viti 2014, ky përbën një fakt shumë të rëndësishëm që nëpunësit civil që kanë akt emërim të përhershëm duhet të ushtrojnë pozitën e tyre konform akt emërimit, ndërsa transferimi i përkohshëm duhet të bëhet mbi bazën e specifikuar në Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, si dhe Rregulloren (QRK) NR.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve të Punës në Shërbimin Civil dhe mbi këtë bazë ligjore transferimi duhet të bëhet konform kësaj baze ligjore.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Zëvendësuesi i Sekretarit të Përhershëm të MKRS-së përveç që nuk është kompetentë të nxjerrë vendim për transferim bazuar në nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, para se të nxirret vendimi për transferim nuk ka bërë analizimin e fakteve nga se ankuesi nuk është i kualifikuar mbi bazën e kritereve që kërkohen për këtë pozitë duke ju referuar nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil sepse ankuesi është i kualifikuar në fushën e sportit respektivisht ka të kryer fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportiv si dhe studimet postë diplomike nga ku ka marrë titullin Doktor i Shkencës në Lëmin e Sportit, fakte që provohen nga shkresat e lëndës që gjenden në ankesën A.nr.1217/2021 që është trajtuar nga këshilli, ndërlidhur me këtë çështje si më lartë, Kolegji konstaton se për pozitën që është transferuar përkohësisht si Udhëheqës i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës përgatitja profesionale për këtë pozitë duhet të jetë Fakulteti Juridik apo Ekonomik, dhe mbi bazë të

këtij kriteri ligjor të arsimimit për këtë pozitë ankuesi nuk plotëson këtë kriter dhe mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Fakti që pas transferimit të përkohshëm të ankuesit, është bërë edhe caktimi i zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit të Sportit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura lidhur me mundësin e zëvendësimit të nëpunësve civil ka paraparë në rastet kur nëpunësi civil përkohësisht nuk e ushtron pozitën (pushim vjetor, mjekësor, trajnim apo të ngjashme), ndërsa aplikimi i dispozitave të nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i referohet rasteve kur nëpunësit mungojnë në punë deri në dymbëdhjetë muaj (pushim i lehonisë, pezullim i marrëdhënies së punës e të ngjashme). Rrjedhimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se me Vendimin me Nr.385/2022 të datës 27.04.2022, i nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përhershëm të MKRS-së, ankuesit i është shkaktuar degradim dhe pasiguri juridike, sepse kur pozitat janë të lira nuk është e domosdoshme që ato të plotësohen me vendime për zëvendësues apo me vendime për transferim të përkohshëm pa plotësuar kriteret për ato pozita nëpunësit civil për faktin që institucionet kanë obligim që këto pozita t'i mbulojnë me procedura përmes lëvizjes brenda kategorisë apo ngritjes në detyrë siç parashihet me nenin 38 dhe 39 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publike, ndërsa ndërlidhur me këtë aspekt transferimi pa i plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për at vend të punës bie ndesh me vetë përmbajtjen e vendimit për transferim që është objekt i kësaj ankese, nga se nuk është interes i institucionit nëse në pozita transferohen zyrtarë pa pasur përgatitje profesionale konformë asaj pozite të punës, edhe në këtë aspekt ky vendim përkundër që bazohet në nenin 52 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në përmbajtje është tërësisht kundër kësaj dispozite, dhe mbi bazë të këtij aspekti pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në pretendimin ankimor konstaton se Vendimi me Nr.57/2022 me nr.ref.1245 /2022 i datës 25.03.2022 për transferim, i nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përhershëm të MKRS-së është nxjerr duke vepruar në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 1 të Rregulloren (QRK) Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve, ashtu si është potencuar më lartë në arsyetim të këtij vendimi, i cili përcakton se: *"Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit me kërkesë të institucionit. Në rastet kur nëpunësi civil kërkohet të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, të ndryshëm nga institucioni ku ai është i emëruar, institucioni që paraqet kërkesën për transferimin e përkohshëm duhet të marrë paraprakisht miratimin e institucionit ku nëpunësi civil është i punësuar"*, kështu që edhe pse Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës është në kuadër të MKRS-së, siç kemi potencuar më lartë nuk ka asnjë dëshmi që udhëheqësi i kësaj Agjencie të ketë kërkuar një transferim të tillë. Po ashtu para transferimit ka munguar komunikimi respektivisht ankuesi nuk është informuara për këtë proces siç parashihet me nenin 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *"Zyrtari publik ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedure dhe çdo vendimmarrje, që ka të bëjë me marrëdhënien e tij të punës"*, nenin 5 paragrafi 2 të Rregulloren (QRK) Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve, i cili përcakton se: *"Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësi përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet"*, kështu që me këtë veprim është shkelur neni 9 paragrafi 2 dhe neni 92 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në të lartcekurat, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i MKRS-së është i obliguar që ankuesin ta kthejë në vendin e punës Drejtor i Departamentit të Sportit sipas Akt Emërimit të datës

29.01.2014 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës që rrjedhin sipas akt emërimit.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit"*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.419/2022, datë 08/06/2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Përfaqësuesit të ankuesit avokatit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- ❖ Udhëheqësit të Njësive të Burimeve Njerëzore në Ministrinë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

